



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT E
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË

MINISTARSTVO OBRAZOVANJA
NAUKE I TEHNOLOGIJE

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

TESTI I MATURËS

ARSIMI PROFESIONAL III (ADMINISTRATË, EKONOMI, ADMINISTRIM BIZNESI, HOTELERI, TURIZËM)

Emri dhe mbiemri i nxënësit


Shkolla.....

EDUKATË QYTETERE

GJEOGRAFI

INFORMATIKË

EKONOMI ME NDËRMARRËSI



Prishtinë, qershor 2015

Emri dhe mbiemri i nxënësit


Shkolla.....

Udhëzime:

Koha: Keni 180 minuta që t’u përgjigjeni 80 kërkesave (pyetjeve). Koha numërohet prej momentit kur do të filloni t’i zgjidhni kërkesat.

Si të veproni?

1. Plotësojini me kujdes, sipas udhëzimeve, të gjitha kodet (në rreth), për: komunën, shkollën, paralelen, numrin e ditarit. Nëse këto të dhëna nuk i plotësoni saktë, nuk do të mund të nxirret rezultati i testit tuaj.
2. Para se të filloni t’u përgjigjeni pyetjeve, qetësohuni plotësisht, sepse kjo do t’ju ndihmojë.
3. Lexojini me kujdes kërkesat dhe pastaj shënojeni vetëm përgjigjen e saktë, nga 4 mundësitë e dhëna, për të cilën besoni se është e saktë.
4. Fleta e përgjigjeve duhet të plotësohet vetëm me laps të thjeshtë - laps HB.
5. Mbusheni kodin (në rreth) e përgjigjes së saktë me laps të thjeshtë, pa e shkarravitur jashtë. Shih shembullin e mëposhtëm.



6. Kini kujdes që përgjigjen e saktë të një pyetjeje të mos ia vendosni pyetjes tjetër të radhës.
7. Në Fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
8. Përgjigjet e sakta plotësohen njëkohësisht – në Test dhe në Fletën e përgjigjeve.
9. Çdo lloj llogaritjeje mund ta bëni në faqen e fundit të testit, ndërsa në fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve, për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
10. Mos humbni kohë me pyetjet që nuk i dini, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për pyetjet e tjera.
11. Përdoreni deri në fund kohën e testimit, në mënyrë që t’u përgjigjeni të gjitha pyetjeve.

EDUKATË QYTETERE

1. Bashkimi Evropian është union i:
 - A. shteteve
 - B. individëve
 - C. familjeve
 - D. komunave

2. Mbretëria e qeverisur nga sundimtari me kompetenca të kufizuara quhet:
 - A. monarki absolute
 - B. monarki diktatoriale
 - C. monarki kushtetuese
 - D. monarki integruese

3. Mjet i demokracisë së drejtpërdrejtë është:
 - A. decentralizimi
 - B. iniciativa
 - C. balanca
 - D. përfaqësimi

4. Ndarja e pushteteve bëhet me qëllim të:
 - A. balancimit të pushteteve
 - B. fuqizimit të njërit pushtet me qëllim të stabilizimit institucional
 - C. shtimit të kontrollit në jetën shoqërore
 - D. parandalimit të monopolizimit eventual të ndonjë kompanie në tregun e lirë

5. Organizata që siguron mbrojtje legale për refugjatë si dhe jep ndihma emergjente në ushqim, ndihmë mjekësore si dhe siguron arsimin dhe lehtësime për komunitetin, quhet:
 - A. UNICEF
 - B. UNHCHR
 - C. UNDP
 - D. UNHCR

6. Studimi shkencor i mënyrës së jetës se si organizmat e gjallë bashkëveprojnë me mjedisin e tyre, quhet:
 - A. energji
 - B. ekologji
 - C. krizë
 - D. ndotje

7. Ombudspersoni Evropian vepron si:

- A. përkrahës i shteteve, anëtarësimi në BE i të cilëve neglizhohet nga Komisionit Evropian.
- B. lehtësues i negociatave midis BE-së dhe shteteve që aspirojnë për anëtarësim në të
- C. ndërmjetës midis qytetarëve dhe autoriteteve të BE-së
- D. ndërmjetës midis shteteve anëtare të BE-së dhe atyre që aspirojnë për anëtarësim

8. Tri organet e pavarura të Bashkimit Evropian, janë:

- A. Komisioni, Parlamenti dhe Sekretariati.
- B. Këshilli, Senati dhe Ombudspersoni.
- C. Parlamenti, Gjykata dhe Komisioni.
- D. Komisioni, Parlamenti dhe Këshilli.

9. Agjencitë e Bashkimit Evropian janë ngritur me qëllim:

- A. të kryerjes së funksioneve të veçanta teknike, shkencore ose menaxheriale
- B. të hartimit të politikave ekonomike
- C. të hartimit të politikave të zgjerimit
- D. të ekzekutimit të politikave ekonomike dhe atyre të zgjerimit

10. NATO-ja është themeluar më 1949 dhe është Organizatë:

- A. për sigurim, e cila merret me kontrollimin e armëve, të drejtat njerëzore, monitorim dhe sigurim të zgjedhjeve dhe që ka 55 shtete anëtare
- B. për sigurimin e mbrojtjes së shteteve të mëdha të Evropës Veriperëndimore dhe Amerikës Veriore, kundër kërcënimit të atëhershëm të Bashkimit Sovjetik
- C. për organizimin e politikës së çmimit dhe furnizimit të shteteve, të cilat prodhojnë naftë dhe për të përmirësuar pozitën e vendeve të botës në zhvillim
- D. për hartimin e politikave monetare të shteteve anëtare, të cilat prodhojnë të mira materiale dhe ofrojnë shërbime për të përmirësuar pozitën e vendeve të botës në zhvillim

11. OSCE-ja është Organizatë:

- A. për sigurimin e politikës së çmimit dhe furnizimit të shteteve, të cilat prodhojnë naftë dhe për të përmirësuar pozitën e vendeve të botës në zhvillim
- B. për sigurimin e mbrojtjes së shteteve të mëdha të Evropës Veriperëndimore dhe Amerikës Veriore, kundër kërcënimit të atëhershëm të Bashkimit Sovjetik
- C. për sigurimin e mbrojtjes legale për refugjatët dhe ofrimin e ndihmave emergjente në ushqim, ndihmë mjekësore si dhe sigurimin e arsimit dhe lehtësimeve për komunitetin
- D. për sigurim, e cila merret me kontrollimin e armëve, të drejtat njerëzore, monitorim dhe sigurim të zgjedhjeve

12. Karakteristika kryesore e diskriminimit është:

- A. trajtimi i barabartë
- B. trajtimi i padrejtë
- C. mirëkuptimi
- D. solidariteti

13.Demokracia është sistem:

- A. politik
- B. teokratik
- C. juridik
- D. ekonomik

14.Fjala “civitas” rrjedhë nga gjuha:

- A. romake
- B. latine
- C. greke
- D. hinduse

15.Kuvendi është organ shtetëror:

- A. ekzekutiv
- B. gjyqësor
- C. legjislativ
- D. familjar

16.Ndihma solidare jepet në formë:

- A. huaje
- B. kamate
- C. kredie
- D. kontributi

17.Në grupin e mediave bëjnë pjesë:

- A. teatri dhe filmi
- B. radio dhe gazeta
- C. shkolla dhe familja
- D. libri dhe libraria

18.Tre pushtetet kryesore në Republikën e Kosovës janë:

- A. komunat, parlamenti dhe legjislativi
- B. kushtetuta, parlamenti dhe gjyqësori
- C. legjislativi, ekzekutivi dhe gjyqësori
- D. kushtetuta, gjykata dhe ekzekutivi

19.Partitë jashtëparlamentare janë parti:

- A. që s'e kanë mbërri pragun zgjedhor
- B. që e kanë mbërri pragun zgjedhor
- C. qeveritare
- D. parlamentare

20.Karta e Magnës (e njohur si *Magna Carta Libertatum*) u nënshkrua nga Mbreti Xhon i Anglisë, më:

- A. 23 tetor 1450
- B. 16 qershor 1215
- C. 21 janar 1530
- D. 23 shkurt 1612

21.Natyrizimi është:

- A. fitim i qytetarisë përmes betimit të besnikërisë në një ceremoni zyrtare
- B. fitim i qytetarisë përmes lindjes në një shtet të caktuar
- C. rikthimi i njeriut në natyrë
- D. pjesëmarrja aktive në veprimtaritë e ndryshme politike

22.Llojet kryesore të varfërisë janë:

- A. subjektive, relative, financiare
- B. absolute, ekonomike, shpirtërore
- C. relative, absolute, subjektive
- D. shpirtërore, materiale , ekonomike

23.Disa nga llojet kryesore të ligjeve janë:

- A. kulturor, ideologjik, penal, civil
- B. etik, kulturor, penal, civil
- C. financiar, familjar, ideologjik, të punës
- D. kushtetues, penal, civil, të punës

24.Vandalizmi përkufizohet si:

- A. krim kundër florës
- B. shkatërrim i pronës
- C. krim kundër njerëzve
- D. përkujdesje ndaj kafshëve

25.Çfarë lloje të mediave ka në Kosovë?

- A. Private dhe publike
- B. Shtetërore dhe publike
- C. Vetëm shtetërore
- D. Vetëm private


GJEOGRAFI

26. Në cilat lloje të hartave paraqiten tipet e tokave?

- A. Hartat hidrologjike
- B. Hartat fitogjeografike
- C. Hartat zoogjeografike
- D. Hartat pedologjike


27. Në një dite pa erë, temperatura e ajrit jashtë shtëpisë është 10°C , ndërsa brenda shtëpisë është 18°C . Cila nga figurat paraqet në mënyrë të qartë modelin e qarkullimit të ajrit, nëse dritarja e shtëpisë është e hapur?

- A. 1
- B. 2
- C. 3
- D. 4



28. Në figurën e dhënë është paraqitur ndryshimi i lëvizjes së ajrit gjatë ditës dhe natës, midis tokës dhe detit, kjo dukuri ndodh sepse:

- A. toka ngrohet dhe ftohet me shpejtë sesa uji
- B. dielli ngroh me shumë ajrin mbi oqeanë sesa atë mbi tokë
- C. ajri i ftohtë tenton të ngjitet lart mbi ajrin e ngrohtë
- D. uji është gjatë gjithë vitit më i ftohtë se toka




29. Në hartën 1:150000 gjatësia prej 12 km është:

- A. 10 cm
- B. 18 cm
- C. 12 cm
- D. 15 cm

30. Lartësia mesë pikave AO paraqet:

- A. lartësinë e troposferës
- B. lartësinë e stratosferës
- C. lartësinë absolute mbidetare
- D. lartësinë relative mbidetare



31.Zonat karstike janë të pasura me:

- A. bimësi
- B. kafshë
- C. ujëra sipërfaqësore
- D. ujëra nëntokësore

32.Shtimi natyror i popullsisë paraqet raportin:

- A. Natalitet-Emigrim
- B. Natalitet-Mortalitet
- C. Imigrim-Mortalitet
- D. Emigrim-Imigrim

33.Në cilën lartësi mbidetare gjendet numri më i madh i popullsisë botërore?

- A. 0-500 metra
- B. 500-1000 metra
- C. 1000-1500 metra
- D. 1500-2000 metra

34.Cili atraksion turistikë bënë pjesë në trashëgimin kulturore?

- A. Liqeni i Ohrit
- B. Parku Kombëtar i Dajtit
- C. Qyteti i Gjirokastrës
- D. Bjeshkët e Nemuna

35.Materiali i depozituar nga veprimi i erës quhet?

- A. Depozitim fluvial
- B. Depozitim glacial
- C. Depozitim lagunor
- D. Depozitim eolik

INFORMATIKË

36. Bartja e të dhënave prej shfrytëzuesit në drejtim të serverit, quhet:

- A. Download
- B. Upload
- C. Serial stream
- D. Paralel stream

37. Cila prej pajisjeve vijuese përdoret për bartjen e të dhënave ndërmjet rrjetit lokal dhe Internetit:

- A. Hub
- B. Switch
- C. Router
- D. Bus

38. Një adresë URL në Internet paraqet:

- A. Web adresë të një resursi të caktuar në Internet
- B. Adresë unike të një shfrytëzuesi të Internetit
- C. Adresë unike të një kompjuteri
- D. Web faqe të zakonshme

39. Cili prej opsioneve të paraqitur paraqet një dyshe të programeve për shfletimin e të dhënave në Web faqe:

- A. Windows Explorer, Internet Explorer
- B. Opera, Windws Explore
- C. Mozilla Firefox, Opera
- D. Internet explorer, Ms Word

40. Shkurtesa DNS është e lidhur me një IP adresë dhe mundëson:

- A. Mundëson lidhjen e disa IP adresave me Web faqet përkatëse
- B. Përkthimin e IP adresës numerike të kompjuterit në adresë me shkronja
- C. Shikimin e Web faqeve me IP adresa
- D. Përcakton madhësinë e web faqeve

41. Interneti punon në bazë të:

- A. Komutimit të paketeve dhe komutimit të qarqeve
- B. Komutimit të qarqeve ose komutimit të paketeve
- C. Komutimit të qarqeve
- D. Komutimit të paketeve

42. Cili është kombinimi i tasteve që përdoret për vendosjen e datës aktuale në qelulë:

- A. Ctrl + ;
- B. Ctrl + ”
- C. Ctrl + >
- D. Ctrl + <

43. Sa do të jetë vlera në celulën A3, nëse skaji i djathtë i poshtëm i qelulave të zgjedhura tërhiqet poshtë:

- A. 0
- B. 1
- C. 2
- D. 3

	A	B
1	1	
2	1	
3		
4		

44. Sa është shuma e numrave binar: $11001+10011$?

- A. 100011
- B. 111110
- C. 111111
- D. 101100

45. Cila prej shprehjeve të listuara më poshtë ka të bëjë me mësimin nëpërmjet kompjuterit, përkatësisht mësimin në distancë:

- A. E-word
- B. E-learning
- C. M-commerce
- D. M- library

46. Nëse një sinjal elektrik $A=10100$ kyçet në portin Not Gate, në dalje do të fitohet:

- A. 01011
- B. 10001
- C. 10101
- D. 00101

47. Sa është numri i gjendjeve që mund të fitohen me një kod 7 bitësh:

- A. 1024
- B. 128
- C. 512
- D. 256

48. Një shifër për identifikim (password) preferohet të ketë:

- A. Shkronja të vogla, numra dhe shenja të interpunkcionit
- B. Shkronja të mëdha dhe numra
- C. Shkronja të mëdha, shkronja të vogla, numra dhe shenja të interpunkcionit.
- D. Shkronja të vogla dhe numra

49. Cila prej memorieve vijuese duhet të rifreskohet shumë herë në një sekond:

- A. RAM-i statik
- B. EPROM
- C. ROM
- D. Ram-i dinamik

50. Për të vendosur një regjister ose numërues në pozitën zero, duhet të përdoret opsioni :

- A. Reset
- B. Remote
- C. Return
- D. Release

51. Si quhet memoria e përkohshme e të dhënave, e cila ndodhet ndërmjet njësive qendrore procesorike dhe njësive periferike dhe e cila ruan të dhënat që presin radhën për ekzekutim, si pasojë e mospërputhjes së shpejtësisë së komunikimit ndërmjet njësive përkatëse:

- A. Main storage
- B. Buffer
- C. Temporary storage
- D. Backing storage

52. Instruksionet dhe adresat e memories paraqiten me:

- A. Kode binare
- B. Kode të karaktereve
- C. Bite të paritetit
- D. Kode ternare

53. Opsioni System Restore do të bëjë të mundur:

- A. Rikthimin e të dhënave që janë fshirë rastësisht
- B. Instalimin e sërishëm të sistemit operativ
- C. Kthimin e gjendjes së sistemit në një moment para dëmtimit të tij
- D. Instalimin e sërishëm të programeve aplikative

54. Në adresën <http://www.search.ieice.org>, pjesa e cila specifikon protokolin për komunikim është:

- A. www.
- B. http
- C. search.
- D. ieice.org

55. Për të dërguar një kopje të postës elektronike te marrësi i cili nuk duhet të shihet nga marrësit tjerë të asaj porosie, duhet shfrytëzuar opsionin :

- A. Bcc
- B. Subject
- C. Cc
- D. To

EKONOMI ME NDËRMARRËSI

- 56.** Nëse çmimi i një produkti rritet nga 1 € në 2€, kurse konsumatori vazhdon të blej 5 njësi si më parë, fuqia blerëse e konsumatorit do të:
- A. rritet për 5€
 - B. zvogëlohet për 5€
 - C. zvogëlohet për 2€
 - D. rritet për 2€
- 57.** Ndërmarrja tregtare që merret me shitjen me pakicë ka kosto totale 15.000€, ndërsa kostot fikse janë 4.500€. Sa janë kostot variabile të këtij biznesi?
- A. 20.000€
 - B. 10.000€
 - C. 10.500€
 - D. 19.500€
- 58.** Cila nga kostot e mëposhtme konsiderohet kosto fikse?
- A. Qiraja e objektit
 - B. Lënda e parë
 - C. Materiali ndihmës
 - D. Lënda djegëse
- 59.** Qëndrueshmëria dhe stabiliteti i kompanisë konsiderohet përparësi e :
- A. firmave individuale
 - B. korporatave
 - C. ortakërive me përgjegjësi të kufizuar
 - D. ortakërive me përgjegjësi të pakufizuar
- 60.** Në cilën formë të tregut firmave hyn më lehtë në degë?
- A. Në oligopol
 - B. Në monopol
 - C. Në konkurrencë të plotë
 - D. Në konkurrencë monopolistike
- 61.** Cilat janë konceptet makroekonomike?
- A. Puna, toka dhe kapitali
 - B. Paga, renta dhe interesi
 - C. Kërkesa individuale dhe oferta individuale
 - D. Inflacioni, punësimi dhe papunësia
- 62.** Cila nga tiparet e mëposhtme e karakterizon ekspansionin ekonomik?
- A. Norma e papunësisë rritet
 - B. Norma e punësimit zvogëlohet
 - C. Norma e papunësisë zvogëlohet
 - D. Norma e punësimit nuk ndryshon

- 63.** Cila nga përgjigjet e mëposhtme shpjegon suficitin tregtar?
- A. Eksporti është më i madh se importi
 - B. Importi është më i madh se eksporti
 - C. Të hyrat publike tejkalojnë të dalat publike
 - D. Të dalat publike tejkalojnë të hyrat publike
- 64.** Çfarë paraqet një rritje e vazhdueshme në nivelin e përgjithshëm të çmimeve?
- A. ekspansionin
 - B. inflacionin
 - C. deflacionin
 - D. rritjen ekonomike
- 65.** Përdorimi i mjeteve tarifore dhe jotarifore për kufizimin, përkatësisht stimulimin e importit dhe eksportit bëhet përmes:
- A. politikës fiskale
 - B. politikës monetare
 - C. politikës së të ardhurave
 - D. politikës tregtare
- 66.** Cili lloj i papunësisë shkaktohet nga rënia e aktiviteteve të biznesit?
- A. Papunësia strukturore
 - B. Papunësia ciklike
 - C. Papunësia friksionale
 - D. Papunësia e fshehtë
- 67.** Cila nga përgjigjet e mëposhtme konsiderohet veti e parasë?
- A. Paraja si masë e vlerës
 - B. Paraja si mjet kursimi
 - C. Qëndrueshmëria e parasë
 - D. Paraja si mjet këmbimi
- 68.** Bilanci i gjendjes paraqet gjendjen pasurore të ndërmarrjes. Çfarë evidentohet në anën e majtë të bilancit përkatësisht në aktivin e bilancit?
- A. Huat afatgjata
 - B. Borxhet ndaj furnitorëve
 - C. Kapitali i sjellur nga aksionarët
 - D. Mjetet e përhershme
- 69.** Denimet e arkëtuara në kontabilitet evidentohen si:
- A. të hyra të jashtëzakonshme
 - B. të dala të jashtëzakonshme
 - C. të dala të rregullta
 - D. të hyra të rregullta

- 70.** Çfarë roli kanë menaxherët e nivelit të lartë të menaxhmentit?
- A. Mbikëqyrës
 - B. Integruës
 - C. Organizativ
 - D. Ekzekutiv
- 71.** Cili funksion i menaxhimit përfshin procesin e rregullimit të aktiviteteve ashtu që performanca reale të jetë në pajtim me qëllimet e pritura të organizatës?
- A. Kontrolli
 - B. Planifikimi
 - C. Udhëheqja
 - D. Organizimi
- 72.** Cila teknikë e përgatitjes së menaxherëve ka të bëjë me krijimin e përvojës në punë përmes kalimit në pozita të ndryshme menaxheriale?
- A. Teknika me mentor
 - B. Teknika e rotacionit
 - C. Kurset dhe programet
 - D. Seminaret e specializuara
- 73.** Çfarë përfaqësojnë puna, toka dhe kapitali?
- A. Të mira normale
 - B. Çmime të faktorëve të prodhimit
 - C. Faktorë të prodhimit
 - D. Produkte dhe shërbime
- 74.** Çka pasqyron problem themelor të çdo sistemi ekonomik?
- A. Shpërndarja e burimeve të kufizuara ndaj nevojave njerëzore të pakufizuara
 - B. Shpërndarja e burimeve të kufizuara ndaj nevojave njerëzore të kufizuara
 - C. Shpërndarja e burimeve të pakufizuara ndaj nevojave njerëzore të kufizuara
 - D. Shpërndarja e burimeve të pakufizuara ndaj nevojave njerëzore të pakufizuara
- 75.** Çfarë është kosto oportune e blerjes së një kompjuteri?
- A. Çmimi i paguar për kompjuter
 - B. Kosto e mirëmbajtjes së kompjuterit
 - C. Diferenca mes çmimit të kompjuterit të blerë dhe të një kompjuteri të përdorur
 - D. Vlera e të mirave të tjera që do të mund të blihen me paratë e shpenzuara për kompjuter
- 76.** Ligji i kërkesës ilustron përmes lakores së kërkesës e cila është:
- A. me pjerrësi negative
 - B. me pjerrësi pozitive
 - C. horizontale
 - D. vertikale

77. Çfarë ndikon në ofertën e firmës për produkte dhe shërbime?


- A. Të ardhurat e konsumatorëve
- B. Çmimet e faktorëve të prodhimit
- C. Pritjet e konsumatorëve
- D. Numri i blerësve

78. Nëse për çmimin 3 euro, firma A ofron 100 njësi produkt në treg dhe firma B ofron 150 njësi, sa do të jetë oferta e tregut?

- A. 450 njësi
- B. 750 njësi
- C. 250 njësi
- D. 300 njësi

79. Duke iu referuar figurës, rretho sasinë dhe çmimin ekuilibër:

- A. çmimi 8 euro, sasia 80
- B. çmimi 10 euro, sasia 100
- C. çmimi 8 euro, sasia 140
- D. çmimi 14 euro, sasia 140



80. Çka paraqet shkalla e reagimit të konsumatorit ndaj ndryshimit të çmimit të produktit?

- A. Elasticitetin e kërkesës
- B. Elasticitetin e ofertës
- C. Ligjin e kërkesës
- D. Ligjin e ofertës